




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Më datë: 15.03.2016

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 29, të datës 07.03.2016, i marr në mbledhjen e datës 29.02.2016 nga Kuvendi i komunës, më datë 15.03.2016 lidhet:

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT
PËR
KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

Ndërmjet palëve:

Komunës së Fushë-Kosovës me adresë në rrugën “Nënë Tereza” pn. në Fushë-Kosovë, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Burim Berisha

dhe

Kishës Ortodokse ‘Svetino Nikola’ me seli në Fushë-Kosovë, të cilën e përfaqëson – Nikolla Dragicevic – Përfaqësuesi i Kishës Ortodokse.

Neni 1

Me anë të kësaj marrëveshjeje Komuna e Fushë-Kosovës dhe Kisha Ortodokse në Fushë-Kosovë janë të pajtimit që të ndihmojnë dhe kontribuojnë në mbulimin e shpenzimeve dhe kryerjen e shërbimeve të varrimit për qytetarët e komunitetit ortodoks me vendbanim të përhershëm në komunën e Fushë-Kosovës.

Neni 2

1. Komuna e Fushë-Kosovës dhe Përfaqësuesit e Kishës Ortodokse përmes kësaj marrëveshjeje kontribuojnë në sigurimin, mbulimin e shpenzimeve dhe për kryerjen e shërbimeve të varrimit, të cekura në vijim:

- 1.1. Sigurimi i Arkivolit në shumë prej 160€;
- 1.2. Sigurimi i Kryqit në shumë prej 30€;
- 1.3. Hapja e varrit në shumë prej 50€;
- 1.4. Transporti deri te vendvarrimi në shumë prej 30€;

Neni 3

Palët përmes kësaj marrëveshjeje sygjerojnë qytetarët që vdekja e personit që ndërron jetë të vërtetohet nga organet kompetente në përputhje me Ligjin për Gjendjen Civile Nr. 2011/04-L-003 si dhe të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm të paraparë më këtë ligj.

Neni 4

Komuna e Fushë-Kosovës për të ndihmuar qytetarët e komunitetit ortodoks të komunës së Fushë-Kosovës, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të varrimit siguron mjetet financiare në shumë prej 165€ për çdo person që ndërron jetë.

Neni 5

Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, të lejuara me vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 29, të datës 07.03.2016, bëhet pas ofrimit të faturave vendore për shërbimet e kryera të varrimit dhe ofrimit të certifikatës së vdekjes nga shërbimet e gjendjes civile të Kosovës për personin që ndërron jetë.

Neni 6

Komuna e Fushë Kosovës mjetet e lejuara në shumë prej 165€, ndihmë në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të varrimit të cekura në pikën e dytë (2) të marrëveshjes për çdo person që ndërron jetë, do t'i transferojë në xhirollogarinë e Përfaqësuesit të Kishës Ortodokse në Fushë-Kosovë në Nr.1153002468000166 në Procredit Bank.

Neni 7

Përfaqësuesit e Kishës Ortodokse marrin për obligim që mjetet e lejuara nga buxheti i komunës t'i shfrytëzojnë për qëllimin për të cilin janë lejuar. Në rast se mjetet nuk shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Komuna mban të drejtën që të ndërpres njëanshëm dhe në çdo kohë marrëveshjen.

Neni 8

Palët më këtë marrëveshje janë të pajtimit që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin përmes bisedimeve me mirëkuptim. Në raste se dështojnë bisedimet për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve, palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 9

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data 29.02.2016 dhe është e plotfuqishme deri më 31.12.2016 me mundësi vazhdimi.

Neni 10

Kjo marrëveshje është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilën palë.

Data e nënshkrimit 15.03.2016



Për Kishën Ortodokse
Nikolla Dragicevic – Përfaqësues

[Signature]



Për Komunën e Fushë-Kosovës
Kryetar i Komunës – Burim Berisha

[Signature]